

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS , në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Mahir Tutuli, kryetar i kolegjit, Rafet Haxhaj dhe Qerim Ademaj, anëtarë, në çështjen juridike të paditësit Kompania e Sigurimeve “Sigkos” me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson sipas autorizimit A.G. nga Prishtina, kundër të paditurës N.SH.T. “Xoni” me seli në Suharekë, për shkak të rimbursimit në shumën e përgjithshme prej 5,000.00 €, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës, të paraqitur kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Ekonomike, III.C.nr.301/2014, të datës 25.09.2015, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 21.09.2017 mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e të paditurës N.SH.T. “Xoni” me seli në Suharekë, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Ekonomike, III.C.nr.301/2014, i datës 25.09.2015, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me aktgjykimin e atakuar, e ka aprovuar në tërësi si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit Kompania e Sigurimeve “Sigkos” me seli në Prishtinë. Nën paragrafin I të dispozitivit, ka detyruar të paditurën N.SH.T. “XONI” me seli në Suharekë, që në emër të rimbursimit të demit, t’ia paguaj shumën e përgjithshme të mjeteve në lartësi prej 5,000.00 €, së bashku me normën e kamatës të cilën e paguajnë bankat si për mjetet e deponuara me afat mbi një vit, e cila do të llogaritet nga data 07.05.2014 e deri në pagesën definitive, në afat prej 7 ditësh nga data e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcënimin e përmbarimit me detyrim. Ndërsa nën paragrafin II të dispozitivit, gjykata e shkallës së parë ka vendosur që secila palë t’i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ka paraqitur ankesë e paditura N.SH.T. “XONI” për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit, aktgjykimin e atakuar të gjykatës së shkallës së parë, ta prish dhe lëndën ta kthejë në rivendosje dhe rigjykim në gjykatën e shkallës së parë.

Përgjigje në ankesë nuk ka.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë i shqyrtoi shkresat e lëndës , aktgjykimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, e pas vlerësimit të tyre në bazë të nenit 194 të LPK , gjeti se:

Ankesa është e pabazuar.

Kompania e Sigurimeve “Lovcen” osiguranje A.D Podgorica, ka parashtruar padi kundër të paditurës, Kompania e Sigurimeve “Illyria” sh.a, për rimbursimin e dëmit për shkak të konfiskimit të polisës së garancionit të cilën e ka blerë e paditura, për çka ka kërkuar nga e paditura t’ia paguaj shumën e prej 5,000.00 €, me kamatë ligjore.

Nga shkresat e lëndës rezulton se e paditura me datë 29.10.2013, e ka blerë nga paditësja polisën e garancisë me nr. 036262 për Sigurimin e Tenderit – “Shtypja e pasqyrave të kontribuuesve pensional” me Nr. Prokurimi: FKPK/13/026/221, për përfituesin e Tenderit “Trusti” ngas i cili është konfiskuar garancia, për shkak se e paditura ka dhënë informacione mashtruese duke ofruar vërtetimin e ATK të falsifikuar. Me datë 12.12.2013, e paditura e ka paguar shumën e garancionit në xhirollogarinë e Fondit Pensional të Kosovës “Trusti”.

Gjykata e shkallës së parë me datë 25.09.2015, ka mbajtur seancë në mungesë të së paditurës, e cila ka qenë e ftuar me rregull dhe mungesën nuk e ka arsyetuar ndërsa nuk kishte dhënë as përgjigje në padi dhe e ka aprovuar në tërësi si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit si ta bazuar ndërsa e ka detyruar të paditurën t’ia paguaj shumën e përgjithshme të mjeteve në lartësi prej 5,000.00 €,

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë e aprovon vlerësimin juridik të gjykatës të shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se, aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par 2. nën pikat b), g), j), k) dhe m) të LPK. Për shkak të zbatimit të rregullt të rregullave të procedurës kontestimore dhe për shkak të konstatimit të rregullt dhe të tërësishëm të gjendjes faktike, drejtë është zbatuar edhe e drejta materiale nga ana e gjykatës së shkallës së parë. Këto shkaqe ankimore i heton dhe vlerëson gjykata e shkallës së dytë sipas detyrës zyrtare e në bazë të nenit 194 të LPK.

Kjo gjykatë vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë ka zbatuar të drejtën materiale respektivisht nenin 960 par.1 të LMD-së, për shkak se nga shkresat e lëndës dhe nga thëniet e palës së paditur rezulton se përgjegjës për konfiskimin e garancisë është vet e paditura ndërsa paditësja ia ka paguar të siguruarit të saj shumën e garancisë dhe me pagimin e saj të gjitha të drejtat e të siguruarit kanë kaluar të paditësja.

Gjykata i vlerësoi pretendimet ankimore të së paditurës, por gjeti se të njëjtat janë ta pabazuara, sepse e paditura në padi nuk e konteston gjendjen faktike por e konteston mbajtjen e seancës në mungesë duke pretenduar se ka pasur arsye për mospjesëmarrje në seancë. Gjykata e Apelit ka gjetur se gjykata e shkallës së parë, drejtë ka zbatuar dispozitën e Nenit 423 të LPK-së, sepse paditësi ka pasur për obligim që ta njoftojë gjykatën për mospjesëmarrje ndërsa ai nuk ka paraqitur as përgjigje në padi për kontestimin e borxhit. Për më tepër nga shkresat e lëndës ka prova të mjaftueshme me të cilën vërtetohet detyrimi i tij ndaj paditëses dhe gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsye të mjaftueshme dhe bindëse për këtë.

Prandaj bazuar në të lartcekurat, kjo gjykatë vlerëson se aktgjykimi i atakuar i gjykatës së shkallës së parë nuk ka të meta për shkak të së cilave nuk mund të vlerësohet ligjshmëria e tij,

dispozitivi i aktgjykimit është i kuptueshëm, nuk është në kundërtënie me vetveten ose me arsyet e aktgjykimit dhe se aktgjykimi përmban arsye të mjaftuara dhe bindëse për gjendjen faktike dhe juridike, për të vendosur në këtë çështje juridike, të cilat në tërësi i aprovon edhe Gjykata e Apelit.

Nga të cekurat u vendos si në dispozitiv në bazë të nenit 195.1 nën pikën d), e lidhur me nenin 200 të LPK .

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS ,
Ae.nr. 15/2016, dt. 21.09.2017

KRYETARI I KOLEGJIT,
Mahir Tutuli,d.v.